



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



HELKETAS
KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
01 Nr. 400/01-3545
22/01/2025

Prishtinë, 2024

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, si dhe Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe duke u bazuar në Raportin vlerësues për Grantin e Performancës Komunale për vitin 2023, periudha e alokimit 2025, të aprovuar nga Komisioni i Grantit për Performancë Komunale, me dt. 30.12.2024, arrihet kjo:

MARRËVESHJE PËR NDARJEN E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE PËR VITIN 2025

Ndërmjet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga z.Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së (në tekstin e mëtejshëm MAPL),
2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga z. Ertan Munoglu, Menaxheri i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejshëm DEMOS) dhe,
3. Komunës së Glogocit, përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejshëm Komuna).

Neni 1

Qëllimi

MAPL dhe HELKETAS pajtohen për ndarjen e mjeteve nga skema e grantit për performancë komunale për vitin 2025.

Neni 2

Financimi

1. Vlera e ndarë e grantit për vitin 2025 për komunën Glllogoc është **1,263,557.36** Euro.
2. Shuma nga pika 1, e këtij neni financohet nga fondet e MAPL-së dhe HELVETAS, proporcionalisht me kontributin e tyre në GPK.
3. Pagesat lidhur me fondet e MAPL-së, bëhen nga MAPL, tek operatorët ekonomik, bazuar në realizimin e punimeve sipas kontratës për implementim të projekteve.
4. Mjetet e HELVETAS, transferohen në buxhetin e komunës përmes Thesarit/MFPT-ës, pas nënshkrimit të marrëveshjeve individuale.

Neni 3

Shfrytëzimi i grantit


Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje, do të nënshkruajnë marrëveshje të veçantë tre palëshe për financim të projekteve në komunë, përmes së cilës do të përcaktohen obligimet, detyrat dhe përgjegjësitë për secilën palë.


Neni 4


Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.

Palët Nënshkruese

Elbert Krasniqi

Ministër i MAPL-së

Ertan Munoglu

Menaxher i projektit DEMOS

Ramiz Lladrovci

Kryetar, Komuna e Glllogocit

